



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Ministria e Shëndetësisë shpall:

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Shëndetësor dhe Shëndetit Publik
<b>Klasa e pozitës</b>	Drejtues i Mesëm
<b>Koeficienti/Paga</b>	8.4
<b>Nr. i kërkuar</b>	1
<b>Kohëzgjatja e emërimit</b>	Me mandat 4 vjeçar
<b>Data e njoftimit</b>	26/11/2024
<b>Afati për aplikim</b>	27/11/2024 - 26/12/2024
<b>Institucioni</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>Departamenti</b>	Departamenti i Shërbimeve Shëndetësore
<b>Divizioni</b>	
<b>Vendi i punës</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00015867
<b>Kodi</b>	RPC0009406



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

1. Mbështet dhe këshillon menaxhmentin e lartë të ministrisë në zhvillimin e politikave dhe objektivave të ministrisë në fushën e shëndetësisë dhe shëndetit publik;
2. Siguron hartimin, mbikëqyrjen dhe vlerëson zbatimin e politikave, strategjive dhe legjislacionit për ruajtjen dhe avancimin e shëndetit publik, përfshirë shëndetin e nënës dhe fëmijës, shëndetin riprodhues dhe shëndetin mendor;
3. Identifikon dhe analizon nevojat për zhvillimin e politikave dhe objektivave institucionale, duke bërë rekomandime strategjike për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore brenda fushës së përgjegjësisë së departamentit;
4. Siguron mbështetje dhe koordinim për funksionimin e institucioneve shëndetësore në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë ndërlidhjen e shërbimeve publike, private dhe publiko-private;
5. Koordinon dhe mbështet aktivitetet me institucionet shëndetësore, profesionistët shëndetësor, institucionet relevante, partnerët strategjik dhe shoqërinë civile për menaxhimin e sëmundjeve ngjitëse, jo ngjitëse, malinje, kujdesin paliativ, sëmundjet e rralla dhe profesionale, shërbimet emergjente në shëndetësi, si dhe shërbimet për shëndetin e nënës, fëmijës dhe shëndetin riprodhues, shëndetin mendor;
6. Mbështet koordinimin dhe zbatimin e politikave dhe aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë ushqimore në bashkëpunim me institucionet shëndetësore, profesionistët shëndetësor, institucionet relevante, shoqatat dhe sektorët përkatës;
7. Koordinon bashkëpunimin ndërmjet kujdesit parësor, dytësor dhe tretësor të shëndetësisë, për të siguruar një zinxhir të pandërprerë të kujdesit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore;
8. Siguron zhvillimin dhe zbatimin e programeve të trajnimit dhe edukimit për profesionistët shëndetësor dhe stafin e institucioneve shëndetësore, duke siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare;
9. Kryen detyra të tjera të caktuara në përputhje me ligjet dhe rregulloret, sipas kërkesave të arsyeshme nga mbikëqyrësi.

## 2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.



### 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

**a) Arsিমimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Mjekësi e Përgjithshme, Mjekësi tjetër dhe Menaxhim tjetër Mjekësor.

**b) Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë një të një nga kërkesat në vijim:

b.1.) tre (3) vite përvojë pune në pozita drejtuese, ose

b.2.) dy (2) vite përvojë pune në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të dytë të arsimit të lartë (master), ose

b.3.) një (1) vit përvojë pune në pozita drejtuese dhe diplomë të nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoraturës).

### 4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

---

- Aftësi të larta organizative, drejtuese dhe për hartim politikash.
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve dhe kërkesave, afateve kohore përmes aftësive të nivelit të lartë analitik dhe zgjidhjes së problemeve.
- Njohuri të gjëra lidhur me fushën e përgjegjësisë së Departamentit, menaxhimin e buxhetit dhe të shërbimit civil.
- Aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi, përfshirë aftësinë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie mirëbesimi me eprorin dhe stafin që e menaxhon.
- Aftësi për të motivuar stafin dhe për të menaxhuar me sukses projektet e Departamentit.
- Njohja e gjuhëve të huaj (e preferueshme).



## 5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

---

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit(vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal.
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (Kandidatët që janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar në institucione publike).
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

### Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se(6) muaj nga data e lëshimit.
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.

## 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 10/01/2025, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net> )

## 7. Kriteret specifike shtesë

---

Nuk ka!

## 8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

## 9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



## 10. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

- Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, njësia përgjegjëse bën verifikimin para emërimit me qëllim të vërtetimit se kandidatët vazhdojnë të plotësojnë kriteret e konkursit, përmes dokumenteve në origjinal apo të njësuara me origjinalin.

Komitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

